V E N D I M
Nr. 318, datë 4.7.2002

PËR VENDOSJEN E OFICERËVE TË KONTAKTIT TË MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK PRANË MINISTRIVE HOMOLOGE TË GREQISË, ITALISË, TURQISË DHE UNMIK-UT KOSOVË, TË ATASHUAR NË PËRFAQËSITË DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 61 të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit" dhe të ligjit nr.8847, datë 19.12.2001 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2002", me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përfaqësimin e Ministrisë së Rendit Publik, me oficerët e vet të kontaktit, pranë ministrive homologe në Greqi, Itali, Turqi dhe UNMIK-ut në Kosovë, të atashuar në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të marrëveshjeve, protokolleve apo procesverbaleve respektive, në luftë të përbashkët kundër trafikut ndërkombëtar të lëndëve narkotike, terrorizmit, krimit të organizuar, trafikut të armëve, emigracionit të paligjshëm dhe pastrimit të parave të pista.

Përfaqësimi të realizohet nga një oficer kontakti, për çdo vend respektiv.

2. Oficerët e kontaktit emërohen nga Ministri i Rendit Publik, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, në përputhje me pikën 4 të nenit 19 të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit" për një periudhë jo më pak se dy vjet. Emërimi i tyre u njoftohet zyrtarisht ministrive homologe ose organeve zyrtare përgjegjëse.

3. Oficerët e kontaktit gjatë veprimtarive të tyre në shtetet respektive mbeten organikë e institucionit që i emëron dhe, në përfundim të misionit, gëzojnë të drejtën e rikthimit në institucionin ku kanë punuar para emërimit në këtë detyrë.

4. Statusi, imuniteti dhe privilegjet që gëzojnë oficerët e kontaktit, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre në vendet respektive, rregullohen sipas marrëveshjeve bazë (protokollet ose procesverbalet) të nënshkruara ndërmjet Ministrisë së Rendit Publik të Republikës së Shqipërisë dhe ministrive homologe respektive, si dhe në përputhje me legjislacionet përkatëse.

5. Oficerët e kontaktit, në vend të pagës, marrin alokacione në valutë. Alokacionet janë në përpjestim me suksesin dhe rreziqet që mbart lufta kundër krimit të organizuar dhe trafiqeve të tjera. Për masën e alokacionit të merret për bazë tabela e pagave, sipas vendimit nr.473, datë 29.9.1993 të Këshillit të Ministrave "Për të drejtat e punonjësve të përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë në shtetet e huaja dhe për shpenzimet e udhëtimit dhe të dietës për personat që dalin jashtë shtetit", me ndryshimet përkatëse. Masa e alokacionit përbëhet nga alokacioni individual dhe shtesat për profesionin. Përveç alokacionit, oficeri i kontaktit përfiton dhe prime motivuese, vlera e të cilave bazohet në meritat individuale dhe nivelin e realizimit të detyrave.

Për këtë qëllim, oficerët e kontaktit barazvlerësohen në gradë me këshilltarin e përfaqësisë diplomatike.

6. Sistemimi me zyrë i oficerëve të kontaktit të bëhet në mjediset e përfaqësive tona diplomatike në vendet respektive. Bashkëshortët dhe fëmijët në ngarkim, gjatë qëndrimit në vendet përkatëse, pajisen me pasaporta diplomatike, si dhe gëzojnë të drejtat dhe detyrimet sipas neneve 20 pika "c", 21 dhe 24 të ligjit nr.8370, datë 9.7.1998 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë". Përfaqësitë diplomatike shqiptare t'u krijojnë të gjitha kushtet e nevojshme për kryerjen e veprimtarisë.

7. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i vitit 2002, miratuar për Ministrinë e Rendit Publik. Kjo ministri të parashikojë fondet përkatëse në buxhetin e vet, për çdo vit për shpenzimet e oficerëve të kontaktit.

8. Ngarkohen Ministria e Rendit Publik dhe Ministria e Punëve të Jashtme për hartimin e udhëzimit të përbashkët dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko